



A është me të vërtetë ky Ausbildung për mua?

Secili mund të gjykojë për vete nëse profesioni i Infermierit (përkujdesesit profesional) është i duhuri për të. A mund të i përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme me “Po”?

- A kam energji të mjaftueshme për të mësuar gjuhën gjermane deri në nivelin B2?
- A jam i ndjeshëm dhe më pëlqen të merrem me njerëz të moshave të ndryshme?
- A jam i interesuar për infermieri, detyrat mjekësore dhe sociale?
- A kam guxim të kujdesem dhe të mbikëqyrë njerëzit me nevoja të ndryshme?
- A mundem të merrem nga afër me njerëz të sëmurë dhe nevojtarë?
- A jam gjithashtu i gatshëm të përgatisë dokumentet administrative për planifikim si dhe të kujdesem për dokumentacionin?
- A mund të punojë në mënyrë të pavarur, por edhe në ekip?



Mbështetja jonë për ju

- Bashkëpunimi në mes të Diakonie Baden-Württemberg dhe APPK-së mundëson migrimin legal, të sigurtë dhe transparent në Gjermani.
- Ne ju mbështesim në aspektin administrativ dhe financiar në procesin e përgatitjes së dokumenteve dhe aplikimit për vizë.
- Ne do të mbulojmë koston e udhëtimit për në vendin tuaj potencial të Ausbildung-ut.
- Me fillimin e Ausbildung, ne do të ju rimburojmë një pjesë të koston të kursit për gjuhë gjermane.

Çfarë bën një Infermier/e

Infermierët mbikëqyrin dhe kujdesen për njerëzit në të gjitha fushat e kujdesit (infermieri, pediatri dhe për të moshuarit) Ata gjithashtu kryejnë urdhëra mjekësore, asistojnë gjatë trajtimeve mjekësore, dokumentojnë të dhënat e pacientëve dhe marrin pjesë në sigurimin e cilësisë.

Infermierët në fushën e kujdesit për të moshuarit mbikëqyrin dhe kujdesen për të moshuarit që kanë nevojë për ndihmë. Ata i mbështesin të moshuarit për përballimin e jetesës së përditshme. Ata i këshillojnë të moshuarit, i motivojnë që të përfshihen në punë domethënëse dhe kryejnë detyra infermiero-mjekësore.



Diakonie

appk

SHKOLLIM DHE
AFTËSIM PROFESIONAL
3-VJEÇAR NË GJERMANI,
PËR PROFESIONIN
INFIERMIER-PËRKUJDESËS
PROFESIONAL
(PFLEGEFACHKRAFT)

Si realizohet Ausbildung

Ausbildung 3-vjeçar i sistemit dual përfshin teori dhe praktikë. Ai zhvillohet në shkollën profesionale dhe në institucionet e Ausbildung. Gjatë Ausbildung-ut, kandidatët marrin kompensim mujor të Ausbildung.

Ausbildung-u njihet jo vetëm në Gjermani, por ne të gjitha shtetet e BE-së.

Kriteret për pjesëmarrje

- Ju jeni të interesuar të përfundoni një Ausbildung 3-vjeçar të sistemit dual në Gjermani.
- Ju jeni të interesuar të punoni në fushën sociale sepse ju pëlqen të punoni me njerëz.
- Ju keni të përfunduar shkollën e mesme.
- Ju jeni mbi 18 vjeç.
- Ju jeni të gatshëm të mësoni gjuhën gjermane deri në nivelin B2. Ju mund të filloni Ausbildung-un kur të zotëroni nivelin B2 të gjuhës gjermane.
- Ju jeni të gatshëm të mbikëqyrni dhe kujdeseni për të sëmurët, të moshuarit dhe njerëzit që kanë nevojë për kujdes.
- Ju jeni tolerantë dhe të hapur për të punuar në ekipe ndërkombëtare.



Fazat e projektit

Faza 1:

- Kontakti i parë (Telefon/E-Mail).
- Takimet informuese me të interesuarit për Ausbildung

Faza 2:

- Aplikacioni me diplomën e shkollës së mesme drejtimi mjekësi apo gjimnaz (me përparësi shkolla e mesme e mjekësisë)
- Biseda prezantuese
- Vendimi për pjesëmarrje në projekt

Faza 3:

- Mësimi dhe përforsimi i gjuhës gjermane

Faza 4:

- Njohja e dëftesave
- Praktikë në një institucion të kujdesit në Gjermani
- Kontrata e Ausbildung

Faza 5:

- Procedura e vizave dhe udhëtimi për në Gjermani

Faza 6:

- Ausbildung 3-vjeçar në Gjermani



Partneriteti APPK—Diakonie

Qe nga viti 2014, APPK në bashkëpunim me Diakonie nga Republika e Baden Württemberg-ut në Gjermani, implementon projekte për Shkollim dhe Aftësim Profesional në Gjermani.

Objektivat e këtyre projekteve janë:

- Ausbildung 3 vjeçar në Gjermani me mundësi të punësimit si kuadër profesional.

- Përvetësim i aftësive dhe kompetencave për profesionin me qëllim integrimin e suksesshëm në tregun e punës në Gjermani dhe Kosovë.

- Shkëmbim i përvojave midis Gjermanisë dhe Kosovës.

Kontaktet tona:

APPK

Str. Rexhep Krasniqi nr. 59, 10000, Prishtinë,
Kosovë
Tel: +383 (0) 38 554 155 | +383 (0) 38 554 166
Mob: +383 (0) 44 507 628
E-mail: info@appk.org
www.appk.org | www.fb.com/appkorg

DIAKONIE

www.diakonie-wuerttemberg.de